



DEPARTAMENTI I AKTEVE RREGULLATRE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA
Drejtoria RIA dhe e Konsultimit Publik

Tiranë, 8 qershor 2026

VLERËSIM

Lënda: Vlerësim i draft raportit të ndikimit rregullator (RIA) për projektligjin “Për kërkesat e transparencës për emetuesit e titujve”.

Vlerësimi i përgjithshëm: 83/100¹ Përgjithësisht pozitiv

A) Informacione të përgjithshme mbi procesin

Emërtimi i propozimit të politikës Projektligji “Për kërkesat e transparencës për emetuesit e titujve”.

Ministria udhëheqëse	MEI
Numri/data e RIAs	2026 – MEI – Nr.9
Statusi	Finalizuar
Data e marrjes për shqyrtim	9 prill 2026
Data e komenteve të fundit	8 qershor 2026
Numri i komenteve të kryera/të reflektuara	41/33
Numri i ripunimeve	4

B) Konteksti i politikës

Qëllimi i kësaj nisme është të forcojë kuadrin rregullator të transparencës për emetuesit e titujve në tregjet e kapitalit, duke siguruar një regjim të unifikuar, koherent dhe të përafuar plotësisht me acquis të Bashkimit Evropian. Nisma synon të rrisë cilësinë, shpejtësinë dhe besueshmërinë e informacionit të rregulluar të publikuar nga emetuesit, të përmirësojë mbrojtjen e investitorëve dhe funksionimin efikas të tregut, si dhe të reduktojë fragmentizimin aktual rregullator, duke kontribuar njëkohësisht në zhvillimin dhe thellimin e tregut të kapitalit në Shqipëri.

C) Vlerësimi i përgjithshëm

¹Pragu minimal i pikëve që një raport RIA të konsiderohet i konfirmuar është 70.

Drejtoria vlerëson përpjekjet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për të siguruar se ndërhyrja e qeverisë është e orientuar aty ku është e nevojshme, duke dhënë rezultate sa më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore dhe administrative.

Megjithatë Drejtoria vlerëson se raporti RIA, në versionin aktual, nuk është në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të ndikimit, për sa i takon evidentimit dhe trajtimin të disa prej rubrikave të tij.

Për arsyet e lartpërmendura, Drejtoria vlerëson se raporti RIA, në versionin aktual, është përgjithësisht në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të ndikimit. Institucioni ka evidentuar problemet duke shpjeguar shkaqet dhe efektet e tyre; grupet e prekura; arsyet e ndërhyrjes dhe lidhjen e nismës me objektivat e nivelit të lartë.

Njëkohësisht, është kryer një analizë mjaftueshmërisht cilësore dhe sasiore mbi ndikimet e mundshme ekonomike/financiare dhe sociale, të opsionit të preferuar. Gjithashtu, çështjet që lidhen me zbatimin e opsionit të preferuar dhe monitorimin e ecurisë së arritjes së objektivave të vendosura janë trajtuar në një mënyrë përgjithësisht të detajuar.

D) Rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të RIAs

Në vijim të gjetjeve të lartpërmendura, konsiderojmë se në mënyrë që RIA të jetë plotësisht në përputhje me kriteret e përcaktuara nga metodologjia, nga ana e strukturës hartuese duhet:

1. Të përshkruhen në mënyrë më të detajuar problematikat kryesore të identifikuara në këtë fushë dhe të identifikohen shkaqet e problemit.
2. Analiza e ndikimit të thellohet dhe të plotësohet në mënyrë gjithëpërfshirëse duke forcuar bazën e të dhënave empirike për emetuesit, kostot dhe shkeljet, si dhe duke zhvilluar një vlerësim më të avancuar që monetizon përfitimet indirekte dhe strukturore të reformës. Gjithashtu, duhet të përfshihen analiza të diferencuara sipas grupeve të aktorëve dhe të adresohen në mënyrë më të plotë ndikimet sociale, makroekonomike dhe ato të sjelljes së tregut, si dhe të integrohet një vlerësim sistematik i rreziqeve dhe efekteve të padëshiruara, për të siguruar një vlerësim më realist, të balancuar dhe të orientuar drejt vendimmarrjes së informuar.
3. Të kryhet një analizë e detajuar sasiore për secilin nga grupet e prekura, duke përshkruar dhe monetizuar qartë kostot dhe përfitimet që rrjedhin nga ndërhyrja ligjore. Të jepen argumentet e arsyetuara në mënyrë objektive për rastet kur është e pamundur kryerja e një analize të mirëfilltë sasiore.
4. Të plotësohet me informacionin e nevojshëm shtojca 2/a dhe 2/b.

